

Nr 1722 prot
Tiranë 30.08.2023 .

MEMORANDUM MIRËKUPtimi

MIDIS

KËSHILLIT TË INVESTIMEVE

DHE

INSTITUTIT TË STATISTIKAVE

NË LIDHJE ME

NDËRTIMIN E NJË KUADRI TË QËNDRUESHËM BASHKËPUNIMI

Qershor 2023

[Signatures]

Ky Memorandum Bashkëpunimi (këtu e në vijim referuar si “Memorandumi”) lidhet midis Këshillit të Investimeve (këtu e në vijim referuar si “KI”) përfaqësuar nga Kryetarja e KI, Znj. Delina Ibrahimaj dhe Institutit të Statistikave, (këtu e në vazhdim referuar si “INSTAT”), përfaqësuar nga Znj. Elsa Dhuli, Drejtor i Përgjithshëm, veç e veç referuar si “Pala” dhe bashkërisht referuar si “Palët”.

Preambula

1. KI është krijuar me VKM Nr. 294 Datë 08.04.2015 si një organ këshillimor, i specializuar dhe ndërmjetës, për lehtësimin e dialogut dhe ndërmjetësimit midis përfaqësuesve të komunitetit të biznesit, donatorëve dhe Qeverisë Shqiptare (këtu e në vijim referuar si “Qeveria”), për zhvillimin e një klime biznesi/investimesh të favorshëm, jodiskriminues dhe transparent;
2. KI promovon qeverisjen e mirë publike dhe të korporatave, përmirëson cilësinë e këshillimit që qeveria merr nga sektori privat dhe adreson problematikat konkrete të paraqitura nga komuniteti i biznesit në vend sa i përket klimës së investimeve dhe çështjeve që lidhen me korrupsionin në vend;
3. KI, nëpërmjet Sekretariatit të tij identifikon pengesat kryesore të të bërit biznes në sektorë të caktuar të ekonomisë dhe miraton rekomandime për reduktimin e barrierave administrative, për reforma institucionale/rregullatore dhe për ndryshime ligjore të cilatju paraqiten institucioneve vendimmarrëse;
4. Sekretariati i mundëson KI-së, ekspertizë ligjore dhe ekonomike për çështje që lidhen objektin e punës së KI sipas parashikimeve të VKM dhe Rregullores së brendshme të KI;
5. KI për përmbushjen e misionit të saj, nëpërmjet Sekretariatit, bashkëpunon me biznese, institucione dhe agjenci qeveritare, institucione ndërkombëtare, organizata jo-fitimprurëse dhe ekspertë me qëllim përgatitjen e rekomandimeve gjithëpërfshirëse dhe transparente të cilat synojnë adresimin e qëndrueshëm të problematikave të identifikuara;
6. INSTAT është institucion publik i pavarur, i krijuar me Ligjin nr. 17/2018 “Për statistikën zyrtare” dhe e ushtron aktivitetin në përputhje me legjislacionin kombëtar për statistikën zyrtare;
7. INSTAT ka bashkëpunuar deri tani me KI dhe Sekretariatin për shkëmbimin e informacionit statistikor;
8. INSTAT vlerëson se bashkëpunimi me KI dhe Sekretariatin është në interes të ndërsjelltë të palëve;

Bazuar në sa më sipër dhe në mbështetje të kuadrit ligjor institucional: Memorandum Bashkëpunimi midis Qeverisë Shqiptare dhe BERZH datë 24 Shkurt 2014; VKM Nr.294, datë 08.04.2015, Rregullores sw KI Nr. 1 datë 01.07.2015; Ligjin nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare” dhe Ligjin nr. 30/2022 “Për Miratimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022-2026”, Palët dëshirojnë të formalizojnë bashkëpunimin e tyre të deritanishëm dhe të ardhshëm në kuadrin e këtij Memorandumi.

Për këtë qëllim Palët merren vesh si më poshtë vijon:

I. QËLLIMI

1.1 Ky Memorandum synon të ndërtojë një kuadër të qëndrueshëm bashkëpunimi midis KI dhe INSTAT-it me qëllim përmbushjen e objektivave të ndërsjellta dhe në funksion të përmirësimit të klimës së biznesit/investimeve në vend dhe cilësinë statistikore.

II. OBJEKTI I BASHKËPUNIMIT

2.1 Palët bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për shkëmbimin e informacionit, përfshirë por pa u kufizuar në:

- të dhëna statistikore;
- opinione dhe analiza ligjore në fushën e statistikave zyrtare;
- ankesa dhe/ose çështje të ngritura nga bizneset si përdorues të statistikave, lidhur me problematikat e hasura në fushën e statistikave zyrtare;
- konferenca, sesione debati dhe/ose bashkëpunime në publikimet e përbashkëta;

2.2 Palët bashkëpunojnë për shkëmbimin e asistencës teknike dhe profesionale si edhe të praktikave më të mira për identifikimin e barrierave administrative të të bërit biznes dhe pasurimin e informacionit statistikor në lidhje me:

- modernizimin e Sistemit Kombëtar Statistikor;
- krijimin e sistemeve informative duke synuar pasurimin e informacionit statistikor dhe bazave të të dhënave;
- organizimin e workshop-eve dhe eventeve të përbashkëta me përfaqësuesit e biznesit me qëllim që të përmbushen kërkesat për prodhim statistikor;
- diskutimin dhe ofrimin e ekspertizës për dokumentet strategjike dhe planifikuese për zhvillimin statistikor;

- kontribuimin në hartimin e projekteve që ndikojnë në rritjen e kapaciteteve profesinale dhe motivimit.

2.3 Palët angazhohen të bashkëpunojnë nga afër në nivel ekspertësh, në fushat ku Sekretariati i KI-së dhe INSTAT-i mund të shkëmbejnë përvojën, njohuritë dhe eksperiencën e ndërsjelltë.

2.4 Palët marrin përsipër kur është e mundur të ngrejnë një kuadër monitorues, për të ndjekur dhe vënë në zbatim rekomandimet e miratura nga KI, duke respektuar legjislacionin e statistikave zyrtare dhe parimet statistikore të miratuara nga legjislacioni shqiptar.

2.5 Palët marrin përsipër të promovojnë aktivitetet e ndërsjellta në forumet ku marrin pjesë.

III. FORMAT E BASHKËPUNIMIT

3.1 Mënyrat e bashkëpunimit të ndërsjelltë përfshijnë por nuk kufizohen në: shkëmbimin e informacionit në rruge zyrtare dhe/ose elektronike, seminare, tryeza të rrumbullakta, takime në nivel ekspertësh, grupe të përbashkëta të punës, ftesa për pjesëmarrje në evente të ndërsjellta si psh. prezantimi i raporteve vjetore, mbledhje të KI-së etj.

3.2 Për efekt të efikasitetit në kohë dhe kosto, njoftimet midis palëve dhe çdo komunikim apo korrespondencë e ndërsjelltë, do të kryhet nëpërmjet postës elektronike dhe kur është e mundur edhe me letër zyrtare në adresat zyrtare të institucioneve.

3.3 Palët angazhohen të jenë të disponueshme në çdo kohë për komunikimin dhe koordinimin me njëra-tjetrën me qëllim rakordimin e veprimeve që duhet të ndërmerren rast pas rasti.

IV. DISPOZITA TË TJERA

4.1 Ky Memorandum reflekton angazhimet dhe synimet e përbashkëta të Palëve për të bashkëpunuar pa paragjykim dhe në mënyrë jopërfashtuese, të shprehura në mirëbesim por pa krijuar asnjë detyrim ligjor apo përgjegjësi për secilën prej Palëve. Nënshkrimi i këtij Memorandumi nga Palët nuk krijon ndonjë avantazh për ndonjë palë të tretë.

4.2 Palët marrin përsipër të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave apo informacioneve me të cilat janë vënë në dijeni gjatë bashkëpunimit të tyre. Ruajtja dhe përpunimi i informacionit të shkëmbyer do të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për konfidencialitetin statistikor dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

4.3 Palët bien dakord se asnjë parashikim i këtij Memorandumi nuk mund të përbëjë as nuk mund të interpretohet si premtim apo sipërmarrje e njëres Palë për të financuar tërësisht apo pjesërisht projektet apo aktivitetet e Palës tjetër.

4.4 Ky Memorandum hyn në fuqi në datën më të fundit të nënshkrimit të tij nga Palët dhe publikohet në faqet zyrtare në internet të secilës Palë.

4.5 Çdo ndryshim në përmbajtjen e këtij Memorandumi është i vlefshëm vetëm i miratuar njëkohësisht dhe bashkërisht me shkrim nga të dyja Palët në formën e një Amendamenti.

4.6 Memorandumi përgatitet dhe nënshkruhet në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

KËSHILLI I INVESTIMEVE



Znj. Delina Tbrahimaj
Kryetare
Datë _____



Znj. Elsa Dhuli
Drejtore e Përgjithshme e INSTAT
Datë _____

